

	KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	01/ 2025
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	16.04.2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë

Haki Hoxha - përfaqësues i Komunitetit Islam

Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik

Enver Shabani - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Bashkim Gashi - përfaqësues e EVSB-së

Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Habibe Bytyqi - Zyrtare për Barazi Gjinore

Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së

Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së

Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së

Rozeta Jahaj - përfaqësuese e OJQ-ve

Refki Zogaj - përfaqësues i Komunitetit të Biznesit

Eurolinda Zenelaj - përfaqësuese e Mediave lokale

Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së

Qëndresa Baftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së

Myrvete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve

Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li

Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve

Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Nënkyetarja e Komunës e cili i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;**
- 3. Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pashpërthyer nga lufta;**
- 4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta;**
- 5. Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve;**

Nënkyetarja - e hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nënkyetarja - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 2. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës;

Nënkyetarja - ia jep fjalën komandantit të policisë.

Afrim Sylaj - përshëndet të pranishmit. Situata e përgjithshme e sigurisë në tremujorin e parë sipas raportit është e qetë dhe stabile. Kemi rritje prej 11 % të rasteve me incidente në tremujorin e parë krahasuar me tre mujorin e vitin 2024. Vrasnje - 0 raste; Grabitje - 0 raste; raste të incidenteve penale nga 64 raste në 2024-112 në vitin 2025; vepra penale 106 në vitin 2024 -118 në vitin 2025; kanosje nga 9 raste tani kemi 13 raste; vjedhje të rënda 17 raste dhe shumica e rasteve kanë ndodh në muajin mars 2025; Raste të raportuara 174 vitin 2024 - 232 vitin 2025; vepra penale nga 106 në vitin 2024 - 118 vitin 2025; zbulueshmëria ka qenë 83 % vitin 2024 - 84% në vitin 2025; aksident me fatalitet 1 rast 2024 - 12 vitin 2025; aksident trafiku me dëme materiale 51 raste në vitin 2024 - 82 vitin 2025; urdhëresat e realizuara të gjykatës 164 viti 2024 - 204 viti 2025; 3055 tiketa janë shqiptua në tremujorin e parë për vitin 2024 ndërsa në tremujorin e parë për vitin 2025 janë shqiptua 3267 tiketa; Përveq këtyre aktiviteteve policia e Kosovës i ka zdatu 152 plane operative ndërsa vitin e kaluar 77 plane operative; 80 vizita në shkolla dhe në kuadër të planit siguria në shkolla janë mbajë 8 ligjera. Sa i përket dhunës në familje për tremujorin e parë, kemi pas 13 raste vitin e kaluar dhe 13 raste këtë vit. Si sfida që i konsideron policia e Kosovës në realizimin e planeve, e kemi infrastrukturën në komunikacion. Kemi probleme me shenjëzim vertikal dhe horizontal në disa rrugë ku paraqesin problem për qytetarët në qarkullim dhe në ndërmarrjen e masave nga policia në parandalimin e aksidenteve të trafikut. Rruga “Skënderbeu” e cila ende s’ka përfunduar është në qarkullim mirëpo nuk ka shenjëzim pastaj kemi rrugë të pariparuar. Ndriçimi në disa pjesë të qytetit është jo funksional në kohë të caktuar dhe kjo na paraqet vështirësi për sigurinë e përgjithshme. Sa i përket bashkëpunimit, bashkëpunimi është shumë i mirë me të gjitha institucionet.

Nënkyetarja - përmendet rastin e rrugës “Skënderbeu”. Unë kam bisedu me Drejtorin e Urbanizmit dhe me Kryetarin dhe meqenëse rruga “Skënderbeu” ende nuk ka përfunduar është e pamundur të vendosen shenjat e sinjalizimit. Shpresoj shumë shpejt me përfunduar rruga dhe të vendosen shenjat. Sa i përket ndriçimit, ju e dini që komuna vazhdimisht i ka kushtu rëndësi ndriçimit dhe jo vetëm në pjesë të qytetit

por edhe në rrugë, rrugica por edhe në fshatra. E vërtetë është që ka shqetësime të qytetarëve që nganjëherë ka prishje por po punohet në atë drejtim.

Refki Zogaj - përshëndet të pranishmit. Unë shpeshherë e kam theksuar dhe po e theksoj dhe e kam pas bisedë edhe me komandantin. Bëhet fjalë për rrugën e Reshtanit që kyqet në Zonën Industriale. Ajo është një humnerë që ne shumë frontime i kemi edhe me makinat e rënda. Aty duhet të vendosen banera. Nëse është bërë pranimi teknik dhe është anashkalua ai gabim fatal, ju lus si komunë dhe si shoqëri që mos të vije deri te një incident me pasoja fatale. Kërkoj nga komuna që vëni në shqyrtim këtë çështje.

Drilon Zyba - përshëndet të pranishmit. Sa i përket shenjëzimit të rrugëve, më e rënda është që leje që nuk është shenja por shenja po është edhe e rrëzune e emri “Besim Ndrecë” ose “Mentor Krasniqi” në këtë rast që e kemi në Bukosh e që është dy herë e rëndë. E para si rrugë që s’ka shenjëzim dhe nuk ka tabelë njoftuese të shkolla në Bukosh dhe të shkolla në Savrovë. A ka kontratë komuna për mirëmbajtjen e shenjëzimit të rrugëve? Nëse ka pse nuk mirëmbahet? Nëse nuk ka kontratë, pse nuk ka?

Nënkryetari - sigurisht që duhet të ketë një kontratë për sinjalizime por kompetentë për këtë është drejtori.

Drilon Zyba - kërkoj që mbledhjen tjetër ta kem këtë informatë sepse është shumë e rëndësishme.

Avni Bytyqi - realisht janë projekte që kërkojnë kosto financiare dhe këto bëhen me planifikim të buxhetit dhe me projekte kapitale. Nuk jam i sigurtë që për këtë vit a ka planifikuar Drejtoria e Urbanizmit që të bëjë shenjëzimin e rrugëve dhe sa i përket se a ka kontratë për mirëmbajtje, nuk jam i sigurtë a ka por nuk besoj që ka kontratë për mirëmbajtjen e shenjave. Komuna e ka kry obligimin ligjor për vendosjen e shenjave të emërimit të rrugëve dhe është në fazën e vendosjes së numrave në gjithë territorin e komunës.

Drilon Zyba - sa i përket shqetësimit që ngriti Refki Zogaj unë kam disa informacione të asaj rruge. Prej 2021-tës kur është shtrur ajo rrugë, në projektin e saj e ka pas me anësore e të gjitha dhe ato nuk janë bërë. Për mendimin tim është e rëndësishme me kërku një hetim të pranimi teknik që është bërë.

Nënkryetari - ne do ta ngrisim këtë çështje në Bordin e Drejtorëve.

Rekomandim: Bashkëpunimi me policinë, qytetarëve dhe organeve tjera për çështje të sigurisë.

Rekomandim: Komuna le ta merr për obligim që të bëjë një projekt dhe në bazë të kërkesave të bëjë shenjëzimin e rrugëve vertikale dhe horizontale si dhe mirëmbajtjen e vendosjes së tabelave orientuese. Me theks të veçantë ta bëjë shenjëzimin e rrugës “Skënderbeu” pas përfundimit të projektit.

Rekomandim: komuna ta shikojë projektin që siç është i planifikuar projekti i rrugës transite në drejtim të Z. Industriale në Shirokë dhe ta shikojë mundësinë për vendosjen e banerave mbrojtëse për skaj.

Afrim Sylaj - Refkiu e ngriti një shqetësim i cili ka dy vite. Aty ne paraprakisht i kemi bërë një kërkesë Ministrisë së Infrastrukturës që në bashkëpunim me këta me i vendos banerat. Interesi i kryetarit të bizneseve ka qenë që mos me ndodhë ndonjë fatkeqësi aty. Kërkesa nuk është realizuar dhe nuk është keq ne prapë me bërë dhe një kërkesë në të ardhmen mirëpo edhe komuna me na ndihmu që banerat me i vendos.

Nënkryetari - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohen rekomandimet

Pika 3. Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve të tjera të pashpërthyera nga lufta;

Nënkryetari - Fatkeqësisht lufta ka lënë pasoja të shumta por në këtë rast në territorin e komunës tonë ka mina dhe mjete tjera të pa shpërthyera andaj duhet të jemi vigjilent. Janë ligjëratat që mbahen nëpër shkolla e cila ka qenë kërkesë e anëtarëve që janë në KKSB, nga FSK-ja.

Avni Bytyqi - KKSJ-ja funksionon mbi bazën e një plani të punës që miratohet në Kuvend me propozimet e antarëve kryesor me pikat kyqe për çështje të sigurisë për qytetarët e Komunës së Suharekës dhe njëra prej pikave që ka qenë prej FSK-së,ka qenë mbajtja e ligjëratave nëpër shkollat ku komuna e shih të arsyeshme dhe të domosdoshme për çështjen e sigurisë së nxënësve dhe vetëdijesimin e nxënësve për çështjen e mjeteve të pa shpërthyer.

Rekomandim: Le ta merr obligim Drejtoria e Arsimit që kur do që e shih të arsyeshme dhe të nevojshme,që brenda muajit maj të bëjë kërkesë në FSK për mbajtjen e ligjëratave dhe FSK-ja ta merr për obligim që ti sjell njerëzit kompetentë që të mbajnë ligjëratat.

Nënkryetari - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevojat të veçanta;

Nënkryetari - Komuna ka bërë disa hapa sa i përket kësaj kategorie dhe jemi mundësi maksimalisht të jemi afër tyre dhe t'ju plotësojmë disa nevojat dhe kërkesat e tyre. Hap debatin

Avni Bytyqi - të gjitha objektet institucionale kanë obligim ligjor që personat me nevojat të veçanta t'ju krijojnë kushte. Tash fatmirësisht edhe ligjet,rregulloret dhe kodi i ndërtimit të BE-së të gjitha shtetet i obligon që investimet që bëhen nëpër hapësira publike por edhe për ndërtime të objekteve të larta që t'ju krijojnë kushte personave me nevojat të veçanta. E di që është shqetësuese objekti i komunës mirëpo komuna çdo herë kur personat me nevojat të veçanta kanë kërkesë dhe dëshirojnë të takohen me Kryetarin apo me ndonjë zyrtar,ne zakonisht i krijojmë hapësirë.

Rozeta Jahaj - përshëndet të pranishmit. Nevojë e veçantë nuk nënkupton një njeri me dobësi ose mangësi dhe një nevojë e veçantë nuk është një person që ka vetëm aftësi fizike. Një individ i cili ka probleme në të folur,në të dëgjuar,në të pamur,në të ecur ose cilido çoftë problemi që ka,me gjithë përfshi dhe me trajtu barabartë në shkollat tona institucionale si gjithë fëmijët tjerë. Në këtë drejtim është punë shumë pak. Nuk nënkupton ne me i kriju hapësirat publike vetëm në rrugë që ata me ec të lire por ne duhet të punojmë edhe në arsim,shëndetësi,secilin drejtim që ne kemi mundësi me punë për këta njerëz. Unë di familje që punojnë vetë me fëmijët e tyre dhe në mënyrë individuale i kryejnë shërbimet,çoftë me logopedin, çoftë me psikologun në shkollat dhe në çerdhe private. Një asistente nuk mund të merret me shumë se me dy fëmijë autik. Pra ne duhet me i dhënë më tepër hapësirë këtyre individëve.

Nënkryetari - pajtohem me ty,por si komunë jemi mundësi me punë në këtë aspekt që këtyre personave t'u ofrojmë kushte. Në shkollat janë asistentet sociale aq sa na është kriju hapësira ligjore.Ne si komunë e kemi prioritet që t'ju krijojmë hapësirë,kushte të dinjitetshme për prind dhe po ashtu edhe për fëmijët me nevojat të tilla.

Habibe Bytyqi - unë e përgëzoj Kryetarin që krijon kushte dhe ka qasje të mirë dhe ofron mundësi për ofrimin e shërbimeve,për atë që cekët ju. Sa i përket pikës së rendit të ditës për qasjen për persona me aftësi të kufizuar,ne të gjithë jemi dëshmitar dhe dimë që të gjitha institucionet publike dhe ato private sa sigurojnë qasje për personat me aftësi të kufizuar. Deri diku të gjitha objektet shtetërore kanë qasje në katin e parë.Në katin e dytë pak institucione,duke fillu nga komuna,shkollat. Në shëndetësi është një lift vetëm në emergjencë dhe nuk punon fare dhe nëse nuk gaboje është dhe në QKMF në Bukosh. Objekti kryesor i QKMF-së nuk ka qasje në katin e dytë dhe aq më shumë është përkeqësua qasja sidomos për lehonat dhe për personat me aftësi të kufizuar. Të gjitha shkollat kanë qasje në katin e parë dhe mospasjen në katin e dytë shkollat e mbulojnë deri diku kur kemi raste me persona me aftësi të kufizuar që klasa të jetë në katin e parë dhe gjithashtu edhe komuna mundohet ti ofroj shërbime këtyre personave. Ne kemi edhe dy kategori të njerëzve që ndoshta janë shumë të lënë anash dhe ndoshta fare nuk kanë qasje. P.sh për personat e verbër ne kemi sinjalizim askund,po ashtu pothuaj të përjashtuar janë edhe personat e shurdhër. Ne nuk e kemi një interpret. I kuptoj pamundësitë por ndoshta është koha ndonjëherë me mendu edhe për ta.Ka qenë një iniciativë e jona që sidomos për personat e shurdhër të paktën ta kemi një

interpret. Komuna të kontraktot shërbime që të paktën vendimet që i marrim në në komunë, të paktën le ti kuptojnë edhe ata.

Nënkryetarja - është e vërtetë ajo që thua. Komuna asnjëherë nuk i refuzon kërkesat e asnjë kategorie e aq më tepër të kësaj kategorie. Këto janë mundësitë tona dhe gjithkund në Kosovë është kështu. Është shqetësuese dhe duhet nga lartë të ngritet zëri i të gjithëve për t'u krijuar mundësitë.

Drilon Zyba - në sheshin në Suharekë janë kubëzat për të verbëritë por alarmantja e saj është që kafja i ka tavolinat në atë pozitë ku komuna i jep leje.

Rekomandim: ti adresohemi inspeksionit ti lirojmë hapësirat publike dhe t'u krijojmë hapësira dhe kushte për lëvizje të lirë qytetarëve me nevoja të veçanta.

Rekomandim: komuna të merr obligim që të krijojë kushte për persona me nevoja të veçanta. Të kontraktot shërbime për çështjen e interpretëve për personat me nevoja të veçanta.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohet rekomandimet

Pika 5. Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesve;

Nënkryetarja - i njofton me pikën dhe hap debatin.

Afrim Sylaj - Ne në disa raste kemi reagu dhe e kemi një plan operativ kur ata lëmshë kërkues vijnë dhe ne i dëbojmë deri në kufi dhe shumica e tyre janë shtetas të Shqipërisë. Në komunën tonë është një numër i vogël mirëpo shumica e tyre lëvizin në ditë tregu ose në ndonjë festë. Aty kur pengohet nganjëherë lëvizja e makinave, ne reagojmë por nuk mungon gatishmëria e policisë ti largoj këta dhe ti dërgoj në gjykatë. Komuna që më së paku është prek nga lëmshë kërkuesit është komuna e Suharekës mirëpo do të reagojmë si polici sa herë që i shohim dhe sa herë që na informojnë qytetarët.

Avni Bytyqi - te çështja e lëmshë kërkuesve zakonisht po e përmendin që janë nga Shqipëria dhe ju çdo herë merrni masa. A ka shqiptua gjykata ndonjë masë të ndalimit të hyrjes së këtyre personave? Sugjeroj që kur ka bëni iniciimin për kundërvajtje, gjyqtari në bazë të ligjit për kundërvajtje ka kompetencë dhe autoritet ta shqiptoj masën e ndalimit të hyrjes për një kohë të caktuar.

Afrim Sylaj - krahas vendimit që e marrin gjobën, e marrin edhe dënimin por fatkeqësisht prej Shqipërisë nuk është kontrolla për shkak të lehtësimit të hyrje-daljeve. Është pak e komplikuar.

Avni Bytyqi - sidomos recidivistëve është mirë me ia ndal hyrjen.

Drilon Zyba - nuk e shoh që ka vetëm nga Shqipëria por ka edhe këtu. Rast konkret është te parkingu i Vivës ku një fëmijë çdo ditë lyp para. Nëse nuk mundemi me dëbu është mirë të paktën me eliminu.

Afrim Sylaj - ai është i mitur nga një fshat dhe paraqitet që nuk e ka gjendjen e mirë. Ai nuk e ka gjendjen e vështirë. Komandanti i policisë tregon edhe për rastet tjera të lëmshë kërkuesve në komunën tonë.

Drilon Zyba - në ato raste duhet me i eliminu, nuk duhet ti lazdrojmë e ti japim pare.

Rekomandim: me gjithë kapacitetet që kanë policia, ti identifikoj dhe ti dëboj.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi